

## Prof. Dr. Rifat Ymeri

In memoriam



Prof. Prof. Dr. Sci. Rifat Ymeri është i lindur në Gjakovë në vitin 1927, ku e kreu shkollën fillore dhe gjimnazin e ulët. Gjimnazin real e përfundoi në Prishtinë ndërsa Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd në vitin 1960. Pas përfundimit të studimeve u punësua në Shtëpinë e Shëndetit, në Gjakovë, ku punoi afër dhjetë vjet, duke ushtruar detyrën e kryeshefit të shërbimit stomatologjik, ndërsa në vitin 1969 punësohet në Shtëpinë e Shëndetit, në Prishtinë. Në vitin 1973 ka specializuar nga lëmia e Sëmundjeve të Gojës dhe të Dhëmbit. Punimin e magjistraturës *“Dëmtimet aksidentale të parodontiumit me zhivë”* e ka mbrojtur në vitin 1976, ndërsa disertacionin e doktoratës *“Dëmtimet e indeve orale në saturnizëm”* e ka mbrojtur në vitin 1981 në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd. Në vitin 1978 krijon marrëdhënie pune në Fakultetin e Mjekësisë, Seksionin e Stomatologjisë në thirrje të asistentit. Më 1982 avancohet në thirrje të docentit, ndërsa

në vitin 1987 në thirrje të profesorit inordinar në lëndën Sëmundjet e gojës. Gjatë kësaj kohe ka ushtruar detyrën e shefit të Klinikës dhe të shefit të Katedrës të Seksionit të Stomatologjisë.

Gjatë kësaj periudhe ka qenë i angazhuar në aktivitet mësimor-shkencor dhe ka ushtruar disa funksione. Ka qenë Kryetar i Seksionit të Stomatologëve të Kosovës, anëtar i Këshillit redaktues të revistës profesionale *“Stomatoloski glasnik Srbije”*, iniciator dhe organizuesi i parë i tubimit profesional shkencor *“Ditët e stomatologëve të Kosovës”*, në Gjakovë, më 1986. Ka publikuar mbi 50 punime shkencor-profesionale; ka përkthyer librin mësimor *“Teknologjia e materialit teknik-dentar”*, ka botuar librin dhe praktikumin mësimor *“Sëmundjet e gojës”* dhe tekstin universitar *“Parodontologjia dhe mjekësia orale”*. Prof. Dr. Rifat Ymeri ka qenë shumë aktiv edhe në vepërimtarinë shoqërore. Ka qenë Kryetar i Klubit të Futbollit *“Vëllaznimi”* të Gjakovës dhe anëtar i Lidhjes dhe Shoqatës së Ligës së Parë Futbollistike të Kosovës. Nga organi i dhunshëm i Seksionit të Stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe larguar nga procesi mësimor më 11.06.1991. Me kalimin e Universitetit të Prishtinës jashtë objekteve mësimore, studentët praktikën e tyre e realizonin në ambulancën e tij, pa asnjë kompensim deri në kthimin në institucione, kur edhe është pensionuar.

Profesori ynë ka qenë udhërrëfyes i denjë për shumë gjenerata të studentëve dhe të stomatologëve, me vizion largpamës për zhvillim, për qasjen serioze dhe përkushtimin maksimal ndaj gjeneratave të reja. Profesori Rifat ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm duke lënë gjurmë të pashlyeshme në stomatologji dhe mjekësi në përgjithësi në vendin tonë.

Prof. Dr. Rifat Ymeri ka vdekur në Prishtinë më 2017.